



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1 Tipike shqiptare! Mamaja i tërheq veshin Rita Orës për postimin e fundit në Instagram
- 2 Ish-lojtari i Interit dhe Milanit Dario Simic arrestohet për korrupsion në Kroaci
- 3 Kiara Ironizon Arbanin pas deklaratas që bëri për të? Moderatorja: Nuk e vërejmë se sa i mjerë është përcjimi ynë
- 4 Statistikat/ Derbi i Piraneje për një vend në finalen e Botërorit, nga Platini e Zidane te Yamal dhe Mbappe! Francë - Spanjë me rivalitet historik
- 5 U largua nga Lazio, Elsad Hysaj gjen akordin me klubin tjetër të Serie A

Kronikë

Kapet me minë me telekomandë në makinë, arrestohet 38-vjeçari në Vaun e Dejës, në kërkim bashkëpunëtori (VIDEO)

I arrestuari është 38 vjeçari Euglen Buraku banues në Spitallë të Durrësit. Gjatë kontrollit u sekuestruan edhe automjeti, një maskë dhe dy telefona celularë.

Kapet me minë me telekomandë në makinë, arrestohet 38-vjeçari në Vaun e Dejës - Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia 5 Korrik, 14:40 | Përditësimi: 5 Korrik, 14:50 f Share Post WhatsApp



Një kontroll policor në orët e para të mëngjesit në fshatin Stajkë të Vaut të Dejës çoi në zbulimin e një mine me telekomandë, e cila sipas Policisë ishte e lidhur me një aparat celular për shpërthim në distancë. Lënda shpërthyesë ndodhej në automjetin që drejtohej nga një 38-vjeçar, i cili u arrestua menjëherë.

I arrestuari është 38 vjeçari Euglen Buraku banues në Spitallë të Durrësit. Gjatë kontrollit u sekuestruan edhe automjeti, një maskë dhe dy telefona celularë.

Për të njëjtin rast është shpallur në kërkim edhe 34 vjeçari me inicialet E. P., banues në Durrës, i dyshuar si bashkëpunëtor.

[Sh] LEXO EDHE: Posta Shqiptare kallëzon punonjësit, dyshohet se vodhën mbi 700 mijë euro në filialin në Durrës! Shkarkohet drejtoresha

Sipas Policisë, aksioni u zhvillua pas informacioneve të marra në rrugë operative dhe u finalizua në kuadër të operacionit të koduar "Remote". Hetimet vijnë për të përcaktuar destinacionin dhe qëllimin e transportimit të minës, si edhe për të identifikuar persona të tjerë që mund të jenë të përfshirë.

Njoftimi i plotë i Policisë së Shtetit

"Vau i Dejës / Policia parandalon një ngjarje të mundshme kriminale. Finalizohet operacioni policor i koduar "Remote". Vihet në pranga një 38-vjeçar, i cili u kap duke transportuar një minë me telekomandë, të lidhur me një aparat celular për shpërthim në distancë.

Shpallet në kërkim një 34-vjeçar, i dyshuar si bashkëpunëtor i 38-vjeçarit. Sekuestrohen, në cilësinë e provës materiale, një minë me telekomandë, një automjet, një maskë dhe dy telefona celularë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vau i Dejës, në bashkëpunim me Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Shkodër, bazuar në informacionet e siguruar në rrugë operative se një shtetas po transportonte një minë me telekomandë, kanë organizuar menjëherë ndërhyrjen, duke parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale.

Rreth orëve të para të mëngjesit, në fshatin Stajkë, u ndalua për kontroll automjeti me të cilin lëvizte i dyshuari. Gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një minë me telekomandë, të lidhur me një aparat celular për shpërthim në distancë. Gjithashtu, u sekuestruan automjeti, një maskë dhe dy telefona celularë.

Në përfundim të veprimeve të para procedurale, u vu në pranga shtetasi E. B., 38 vjeç, banues në Spitallë, Durrës. Gjithashtu, u shpall në kërkim shtetasi E. P., 34 vjeç, banues në Durrës, i dyshuar si bashkëpunëtor në këtë rast.

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijnë veprimet hetimore për sqarimin dhe dokumentimin e plotë ligjor të rastit, përcaktimin e destinacionit dhe qëllimit të transportimit të minës, si dhe identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë"

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder Durres vau i dejes mine me telekomande

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[SH] Sondazhi i ditës: Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare? 14 Korrik, 12:01 Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI)

14 Korrik, 10:10




Sherr me thika mes të rinjve në Fushë-Krujë, 22-vjeçari përfundon te Trauma (VIDEO)

13 Korrik, 21:43



Blokohen 110 litra verë e padeklaruar në portin e Durrësit, shoferi gjobitet me trefishin e detyrimit

13 Korrik, 12:51



Vrau bashkëshorten për xhelozë, gjykata e Shkodrës li në burg 64-vjeçarin! Asnjë fjalë në seancë (VIDEO)

13 Korrik, 10:34



Kultivonin kanabis, pranga 31-vjeçarit në Krujë, në kërkim bashkëpunëtori (VIDEO)


13 Korrik, 09:15



Ura e Mesit në Shkodër mahaj: Vendi më i bukur në botë, me njerëzit më të mirë (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 14:21



Ekzekutimi i 40-vjeçarit në Shkodër, policia sekuestron 25 gëzhoja në vendin e ngjarjes! Pista e hetimit, gjakmarrja (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 10:21



U quajt 'Ura e Vezirit', për nder të Mehmet Pashë Bushatit, historia e panjohur e urës së famshme që komunistët i vunë minat në '80-ën

Ali Hasani

12 Korrik, 09:57



Shkodër/ 40-vjeçari vritet me armë zjarri brenda automjetit! Dyshime për hakmarrje, i vëllai në 2017-ën ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh dhe çështje nderi

11 Korrik, 20:02



Festa e Liqenit në Shkodër, natyrë, traditë e përvojë unike! Turistët e huaj: Shqipëria është një vend i mrekullueshëm


Ergys Kavaja

11 Korrik, 16:33



IGJEUJ paralajmëron: Sot, situata më kritike nga zjarret! 6 qarqet me rrezik më të lartë

11 Korrik, 16:04



Porti i Durrësit përgatitet për fluksin e verës, tragetet drejt Italisë nisin lundrimet e dyfishta nga kjo fundjavë

10 Korrik, 15:45





